

Activity supported by the  
Canada Fund for Local Initiatives  
Activité réalisée avec l'appui du  
Fonds canadien d'initiatives locales

Canada



# **VLERËSIMI I FAKTORËVE NXITËS SI DHE REKOMANDIME PËR ADRESIMIN E FENOMENIT TË RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM TEK TË RINJTË**

**Tiranë, Mars 2017**

*Ky Vlerësim është përgatitur nga ekspertët e Institutit Shqiptar për Studime Ligjore dhe Territoriale (A.L.T.R.I) në kuadër të projektit me temë “Roli i medias sociale dhe rritja e ndërgjegjësimit të të rinjve ndaj fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm”, financuar nga Canada Fund for Local Initiatives. Opinonet e shprehura në këtë Studim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht mendimet e donatorit.*

## Përmbajtja e lëndës

Parathënie.....	3
Kapitulli I: Media sociale, radikalizimi dhe ekstremizmi i dhunshëm .....	4
1.1. Përkufizimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.....	4
1.2. Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar .....	7
Kapitulli II: Metodologjia e aplikuar .....	11
2.1 Qasja metodologjike .....	11
2.2 Angazhimi i palëve të interesuara dhe vështirësitë e hasura.....	15
Kapitulli III Vlerësimi i ndikimit të medias sociale dhe i faktorëve të tjerë në nxitjen e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë.....	16
3.1 Vlerësim mbi karakteristikat dhe faktorët nxitës së fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm .....	16
3.2 Vlerësimi i nivelit të ndikimit të medias sociale.....	18
3.3 Identifikimi i problematikave në parandalimin e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm .....	18
Kapitulli IV Rekomandime.....	23

## PARATHËNIE

Interneti ofron mundësi të mëdha për të mbështetur realizimin e Axfordës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030 dhe avancimin e të gjitha të drejtave të njeriut, duke përfshirë qasjen në informacion, lirinë e shprehjes dhe privatësinë “on-line”. Gjithashtu është e gjerësisht e pranuar se format e pakontrolluara dhe efektet e lidhura me të, mund të çojnë në rezultate të padëshirueshme. Prandaj është shumë i rëndësishëm promovimi i vetëdijes në mesin e të gjithë aktorëve, nxitja e debatit, reflektimi dhe gjetja e zgjidhjeve adekuata për të zbutur rezultatet negative që rrjedhin nga përdorimi i internetit. Në diskutimin popullor merret si i mirëqenë fakti se interneti dhe mediat sociale, luajnë një rol të rëndësishëm në radikalizimin e të rinjve, sesa si një burim i ndryshimeve pozitive. Humbja e jetës, pasigurisë dhe diferencat e mëdha sociale që ndodhin kur radikalizmi përshkallëzohet në sjellje ekstremiste, e bën të kuptuarin e nxitësve dhe faktorëve për përshkallëzimin e radikalizimit, një shqetësim të rëndësishëm të politikave publike.

Sfida për qeveritë dhe të gjithë aktorët e tjerë është për të kuptuar gamën e faktorëve në të cilën mediat sociale mund të luajnë një rol, me qëllim që përgjigjet të mos jenë të gabuara apo të bazuara në supozime të pa mbështetura. Mbi këtë bazë, mund të jetë e mundur identifikimi i hapave të duhur për të neutralizuar veprimtarinë e radikalizmit në internet dhe për të siguruar kornizat e duhura ligjore, institucionale, administrative dhe edukative për t’iu përgjigjur kërcënimit, në përputhje të plotë me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar për të drejtat e njeriut.

Një nga objektivat e Axfordës së Zhvillimit të Qëndrueshëm 2030, tërheq vëmendjen për parandalimin e dhunës, si një faktor kritik në realizimin e një jetese të qëndrueshme. Kjo tregon nevojën për të përgatitur të gjithë qytetarët, veçanërisht të rinjtë, për të shfrytëzuar teknologjitë e informacionit dhe komunikimit (TIK), si një shtyllë për ndërtimin e paqes dhe realizimin e zhvillimit të qëndrueshëm.

Për këtë arsye është i nevojshëm reflektimi në atë se çfarë do të thotë promovimi i komunitetit virtual të internetit si një hapësirë për qytetarët për të praktikuar të drejtat dhe qytetarinë e tyre “online” dhe “offline”. Të paktën, kjo kërkon mundësisht një mjedis social, teknik, politik dhe arsimor, aftësinë për të pasur akses në rrjete si dhe individë të pajisur me aftësitë e duhura, qëndrimet dhe kompetencat për të përdorur internetin në mënyrë korrekte. Më shumë se kaq, ajo kërkon të kuptuarit e shkallës në të cilën mund të abuzohet me mediat sociale dhe kur kjo i përshtatet një sërë faktorësh, që mund të promovojnë apo të kërcënojnë sjelljet paqësore.

Hapat duhet të sigurojnë që liria e shprehjes dhe privatësia janë të lirë nga ndërhyrjet arbitrare, të paligjshme apo joproporcionale, dhe janë në gjendje për të ruajtur karakteristikat e internetit të hapur, përfshirës dhe që kontribuon në zhvillimin e qëndrueshëm dhe prosperitetin e shoqërisë moderne.

Prandaj është e domosdoshme ndërmarrja e vlerësimeve për të fituar njohuri më të mëdha të lidhjeve mes radikalizmit dhe mediave sociale. Qëllimi i këtij projekti të ndërmarrë nga qendra ALTRI është pikërisht vlerësimi i rolit luajtur nga mediat sociale në procesin e radikalizimit të të rinjve në Shqipëri, rritjen e ndërgjegjësimit për efektet negative si dhe ofrimin i një pakete rekomandimesh për të gjithë aktorët dhe faktorët e përfshirë në këtë proces.

## KAPITULLI I: MEDIA SOCIALE, RADIKALIZIMI DHE EKSTREMIZMI I DHUNSHËM

### 1.1 Përkufizimi i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

Duhet theksuar se nuk ka përkufizim konsensual dhe të qartë në lidhje me termin “radikalizim” që mund të gjendet në instrumentet ekzistuese ligjore ndërkombëtare pavarësisht nga numri i madh i instrumenteve të tilla që kanë të bëjnë me terrorizmin dhe pavarësisht rezolutave të ndryshme dhe literaturës së gjerë mbi këtë temë.

Ekziston një konsensus, e parë në këndvështrimin ligjor dhe në një farë mase dhe në atë psikologjik, që “radikalizmi” është një fenomen më abstrakt dhe më i gjerë sesa konceptet që lidhen me "terrorizmin" dhe "ekstremizmin e dhunshëm".

“Radikalizimi” përshkruhet si një proces që ka shumë të ngjarë të çojë në akte të kualifikuara shpesh si terrorizëm ose ekstremizëm, por jo domosdoshmërisht (aktet e dhunshme që mund të rezultojnë nga radikalizimi, mundet në disa raste të cilësohen si "kryengritje", "rrebelim", "luftë civile" apo edhe "luftë").

Në kundërt me "radikalizmin", "terrorizmi" është direkt ose indirekt i përcaktuar në disa rezoluta dhe traktate.

**Këshilli i Bashkimit Evropian** e përkufizon "terrorizmin" si: *"akte të qëllimshme që janë kryer me qëllim frikësimin, në mënyrë serioze, të një popullsie, ose duke imponuar në mënyrë të padrejtë një qeveri apo organizatë ndërkombëtare për të kryer ose për tu përbajtur nga kryerja e ndonjë veprimi, apo të destabilizojë/shkatërrojë në mënyrë serioze, strukturat themelore politike, kushtetuese, ekonomike ose sociale të një vendi ose një organizatë ndërkombëtare"* (Komisioni Evropian 2006).

**Organizata e Kombeve të Bashkuara** nuk kanë asnjë përkufizim të dakordësuar ndërkombëtarisht në lidhje me terrorizmin, ekstremizmin e dhunshëm ose radikalizmin. Një nga arsyet duket të jetë vështirësia në akomodimin e shqetësimeve të ngritura nga Organizata e Konferencës Islamike e cila shprehimisht përjashton luftën e armatosur për çlirim nga pushtimi dhe luftën për vetëvendosje (self-determination).

**Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara megjithatë ka zhvilluar**, në rezolutën e saj nr. 1566 të vitit (2004), tri kritere kumulative për të karakterizuar "terrorizmin" si vijon: (i) synimi; (ii) qëllimi; dhe (iii) sjellja e veçantë, ku përfshihen:

i. veprimet kundër civilëve, të kryera me qëllim për të shkaktuar vdekje ose lëndim të rëndë trupor, ose marrjen e pengjeve;

ii. pavarësisht nëse është motivuar nga konsiderata të natyrës politike, filozofike, ideologjike, raciale, etnike, fetare apo të një natyre tjetër të ngjashme, me qëllim provokimin e gjendjes së terrorit në publikun e gjerë ose ndaj një grupi individësh apo individë të veçantë, nëpërmjet frikësimit të popullsisë ose imponimit ndaj një qeverie apo një organizatë ndërkombëtare për të kryer ose të mos kryer ndonjë veprim; dhe

iii. të cilat përbëjnë vepra penale brenda fushëveprimit të dhe siç përcaktohet në, konventat dhe protokollet ndërkombëtare në lidhje me terrorizmin.

**Në nivel evropian** një përkufizim i termit "radikalizëm" nuk ka qenë i mundur të shfaqet nga jurisprudenca e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Gjykata nuk e ka përdorur këtë term (përveç një here, në një rast nga viti 2013, në një kontekst të ndryshëm, në kuadrin e një greve urie).

**Konventa e Këshillit të Evropës për Parandalimin e Terrorizmit**, të datës 16 maj 2005, nuk e përcakton termin "radikalizëm" por përmban përkufizimin "për provokim publik për kryerjen e veprës terroriste" (neni 5): "*shpërndarja, ose vënia në dispozicion, të një mesazhi për publikun, me qëllim për të nxitur kryerjen e një veprë terroriste, ku një sjellje e tillë, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo, përkrah veprat terroriste, shkakton rrezikun që një ose më shumë vepra të tilla mund të kryhen.*"

Konventa përcakton gjithashtu "rekrutimin për terrorizëm" (Neni 6) si akt: "*për ti kërkuar një personi tjetër për të kryer ose për të marrë pjesë në kryerjen e veprës terroriste, ose për t'iu bashkuar me një grupim, me qëllim për të kontribuar në kryerjen e një apo më shumë veprave penale terroriste nga ana e këtij grupimi.*"

Shumica e përkufizimeve të përdorur aktualisht e përshkruajnë radikalizmin si proces ku individë ose grupe individësh vijnë, miratojnë dhe (në fund të fundit) marrin pjesë në përdorimin e dhunës për qëllime ideologjike, politike apo fetare. Disa autorë i referohen "radikalizmit të dhunshëm", për të theksuar rezultatin e dhunshëm dhe dallimin e procesit nga forma jo të dhunshme "radikale" të të menduarit.

***Të gjithë terroristët janë radikal dhe jo të gjithë radikalët janë terroristë, për faktin se jo të gjitha format e radikalizmit dhe ekstremizmit, evoluojnë në dhunë dhe terror.*** Radikalizmi nuk përbën kërcënim për një shoqëri, në rast se nuk lidhet me dhunën apo veprime të tjera të paligjshme, të tilla si: nxitja e urrejtjes, sipas përshkrimit në jurisprudencën që lidhet me

legjislacionin ndërkombëtar për të drejtat e njeriut. Radikalizmi mund të rezultojë si një forcë pozitive ndryshimi.

Sa për ilustrim, individët që luftuan për heqjen e skllavërisë apo ata që kërkuan të drejtën universale të votës, për kohën në të cilën jetuan, u konsideruan si radikalistë, duke qenë se ishin kundër ideve mbizotëruese në shoqëritë e tyre. Radikalizmi terrorist është një proces dinamik, sipas të cilit individi nis ta pranojë dhunën terroriste, si një rrugë të mundshme, madje edhe legjitime të veprimit.

Nuk ka asnjë profil të vetëm, i cili do të përfshinte të gjithë radikalistët apo ekstremistët e dhunshëm, sikundërse nuk ekziston asnjë rrugë “e prerë me thikë“, e cila i çon individë të tillë, në rrugën drejt terrorizmit. Shtysat e mundshme të “radikalizmit terrorist” janë të ndryshme dhe komplekse, duke u ndërthurur në mënyrë unike për çdo rast specifik. Profilët që ndërtohen mbi bazën e supozimeve të stereotipizuara, mbi bazën e përkatësisë fetare, racore, etnike, gjinore, statusit shoqëror dhe ekonomike etj, jo vetëm që janë diskriminuese por po ashtu janë edhe të paefektshme.

Është plotësisht llogjike që të hidhet poshtë me vendosmëri identifikimi i radikalizmit dhe ekstremizmi i dhunshëm apo dhe i terrorizmit me kombësinë, përkatësinë fetare apo etnike. Përballja me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm kërkon një reagim të sofistikuar dhe gjithëpërfshirës. Kjo duhet të përfshijë veprime efikase të drejtësisë penale, në përputhje me standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut dhe sundimit të shtetit të së drejtës kundër atyre që nxisin të tjerët për akte të dhunshme, si edhe përpjekje shumëplanëshe për trajtimin e kushteve që favorizojnë radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm.

Shqipëria konsiderohet tradicionalisht një vend tolerant, me dialog konstruktiv ndërfaqet dhe një radikalizim të kufizuar. Megjithatë, radikalizimi është një kërcënim global dhe në vitet e fundit, Shqipëria ka qenë gjithashtu e prekur, së bashku me disa shtete anëtare të BE-së dhe vendeve të Ballkanit perëndimor, nga fenomeni i luftëtarëve të huaj (Foreign Fighters). Që nga viti 2014, rreth 114 shtetas shqiptar, disa prej tyre, së bashku me anëtarët e familjes, janë larguar nga vendi për t'u bashkuar me zonat e luftës në Lindjen e Mesme. Rreth 40 luftëtarë të huaj janë kthyer në Shqipëri dhe jetojnë në kushte të përjashtimit apo vetë-përjashtimit social.

Raporti Vjetor i Komisionit Evropian 2015, ka njohur përpjekjet e Shqipërisë për të trajtuar radikalizimin dhe terrorizmin dhe i bënë thirrje Shqipërisë të "zhvillojë një politikë efektive për të parandaluar radikalizmin, duke përfshirë masat për zbatimin e ligjit dhe veprimeve socio-ekonomike që kanë për qëllim forcimin e përfshirjes sociale, veçanërisht në mesin e të rinjve, si dhe për të rritur përpjekjet për të identifikuar dhe parandaluar dhe rrjedhën e luftëtarëve të huaj që udhëtojnë në zonat e konfliktit si Irak dhe Siri".

Është fakt që disa zona gjeografike e vendit janë më të prekshëm ndaj radikalizmit, në mënyrë të veçantë në zona të vogla me disavantazhe social-ekonomike, me qasje të pakët në mundësitë e punësimit dhe arsimimit. Faktorët kryesorë shtytës për radikalizim i atribuohet kryesisht

mungesës së arsimit dhe mundësive të punësimit. Në zonat e marginalizuara, kjo është e shoqëruar shpesh me mungesën e shërbimeve sociale dhe zhgënjimit me institucionet publike. Kjo krijon kushte të favorshme për propagandë ekstremiste, që synojnë kryesisht të rinjtë, të cilët janë grupi kryesor në rrezik.

## 1.2 Kuadri ligjor ndërkombëtar dhe kombëtar

Të ballafaquar me kërcënimin e radikalizmit, duke çuar në përhapjen e terrorizmit në të gjithë botën, bashkësia ndërkombëtare ka ndërmarrë një numër iniciativash dhe ka miratuar në mënyrë konsensuale një numër instrumentash që përfshijnë edhe kufizimet dhe monitorimin e përmbajtjes në internet.

Më 8 shtator 2006, **Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara** ka miratuar **Strategjinë Kundër-terrorizmit global**. Strategjia është një instrument unik global për të rritur përpjekjet kombëtare, rajonale dhe ndërkombëtare për të luftuar terrorizmin. Nëpërmjet miratimit të tij, për herë të parë, të gjitha shtetet anëtare, kanë rënë dakord për një qasje të përbashkët strategjike dhe operacionale për të luftuar terrorizmin, jo vetëm duke dërguar një mesazh të qartë se terrorizmi është i papranueshëm në të gjitha format e manifestimit të tij, por edhe vendosmërinë për të marrë hapa praktikë, në mënyrë individuale dhe kolektive, për të parandaluar dhe luftuar atë. Këto hapa praktike përfshijnë një gamë të gjerë masash duke filluar nga forcimi i kapacitetit të shtetit për t'iu kundërvënë kërcënimeve terroriste, për të koordinuar më mirë veprimtaritë kundër terrorizmit në kuadër të sistemit të Kombeve të Bashkuara. Kjo Strategji përfshin një seksion të plotë mbi: "Politikat e internetit", në të cilën, ndërmjet të tjerash, theksohet se:

*“Vitet e fundit kanë treguar një përdorim në rritje të internetit nga ekstremistët e dhunshëm, si një mjet për përhapjen e propagandës, nëpërmjet grumbullimit të fondeve, rekrutimin e anëtarëve të rinj, dhe komunikimin me aktivistët e tyre. Ekstremistët e dhunshëm kanë përdorur edhe internetin si një kamp trajnimi virtual duke krijuar forma të ndryshme të komunikimit “on line”, person me person ose komunikimin në grup, për të shkëmbyer përvoja dhe njohuri.*

*Ekstremistët e dhunshëm kanë arritur me sukses të kthejnë, përfitimet e mëdha të internetit - kosto të ulët, lehtësinë në akses, mungesës së rregullimit në shumë pjesë të botës, audiencë e gjerë, komunikimi i shpejtë dhe rrjedhja e informacionit, në një mjet për të arritur qëllimet e tyre dhe për të tërhequr rekrutë. Pyetja se si mund të kufizohet abuzimi i terroristëve me internetin është diskutuar në mënyrë të vazhdueshme dhe të debatueshme në pjesë të ndryshme të botës”.*

**Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, Ban Ki-Moon**, në 29 maj 2015, shprehu shqetësimin e Kombeve të Bashkuara për rritjen e luftëtarëve të huaj që i bashkohen grupeve terroriste, duke theksuar nevojën e *“Inkurajimit të kërkimeve mbi lidhjen ndërmjet keq-përdorimit të internetit dhe medias sociale nga ekstremistët e dhunshëm dhe faktorët që çojnë individët në drejtim të ekstremizmit të dhunshëm”*.

**Kombet e Bashkuara**, kanë miratuar më datë 24 dhjetor 2015 **"Planin e Veprimit për Parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm"**, duke e konsideruar parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm, një angazhim dhe detyrim, që bazohet në parimet dhe vlerat e përcaktuara në Kartën e Kombeve të Bashkuara, Deklaratën Universale për të Drejtat e Njeriut dhe instrumenteve të tjerë ndërkombëtarë që lidhen me të drejtat e njeriut. Që ky parandalim të jetë efektiv dhe i qëndrueshëm dhe në një linjë me detyrimet ndërkombëtare të shtetet anëtare, Plani i Veprimit përcakton se i gjithë legjislacioni, politikat, strategjitë dhe praktikat e miratuar për të parandaluar ekstremizmin e dhunshëm, duhet të bazohen fuqimisht në respektimin e të drejtave të njeriut dhe shtetit të së drejtës.

Në këtë Plan, Sekretari i Përgjithshëm kërkon një qasje gjithëpërfshirëse që përfshin jo vetëm masat e domosdoshme kundër terrorizmit të bazuara në elementët e sigurisë, por edhe hapat sistematike parandaluese për të adresuar kushtet themelore që shtyjnë individët të radikalizohen dhe të bashkohen me grupet e dhunshme ekstremiste.

Plani është një thirrje për veprim të përbashkët nga ana e komunitetit ndërkombëtar. Ai ofron më shumë se 70 rekomandime për shtetet anëtare dhe sistemin e Kombeve të Bashkuara, për të parandaluar, përhapjen e mëtejshme të ekstremizmit të dhunshëm.

**Plani i Veprimit për Parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm**, përcakton, ndër të tjera, se:

*"Ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri diverse, pa përcaktim të qartë. Mesazhet intolerante të këtyre grupeve, kanë pasur pasoja drastike për shumë rajone të botës. Nëpërmjet mbajtjes së territoreve dhe **përdorimit të mediave sociale** për komunikime globale në kohe reale të ideve të tyre, ata kërkojnë për të sfiduar vlerat tona të përbashkëta të paqes, drejtësisë dhe dinjitetit njerëzor”*.

I njëjti shqetësim në rritje dhe ndërveprim përse i përket rolit të internetit në radikalizimin e të rinjve dhe çuarjen drejt terrorizmit, konstatohet edhe në nivelet e ndryshme vendimmarrëse të **Bashkimit Evropian**. Si një reagim ndaj këtyre sfidave dhe përpjekjeve është edhe **Komunikata nga Komisioni Europian "Parandalimi i radikalizimit në terrorizmin dhe ekstremizëm të dhunshëm: Forcimi i reagimit të BE-së"** (15 janar 2014), në të cilën, ndër të tjerash, theksohet se :



*“Me shqetësimin gjithnjë e në rritje mbi radikalizmin “on line”, shtetet anëtare janë duke u ndeshur me këtë fenomen shqetësues. Në të gjithë Bashkimin Evropian rreziku i radikalizimit që çon në dhunë ekstremiste është në rritje, dhe vendet anëtare do të duhet të përfitojnë nga rritja e përpjekjeve të tyre për t’iu përgjigjur në mënyrë efektive këtyre sfidave. Radikalizimi i kalon kufijtë kombëtarë në shumë mënyra. Për shembull, përdorimi i **dhomave të komunikimit (chat rooms), medias sociale**, si dhe instrumenteve të tjerë on line, shpesh ka një dimension ndërkombëtar. Lloji i kërcënimeve që vendet anëtare përballen janë shpesh të ngjashme, kështu që mund të jetë efektive marrja e veprimeve në nivel të BE-së”.*

Më herët (2007), **Këshilli i Bashkimit Evropian** miratoi disa ndryshime në **Vendimin Kuadër nr. 2002/475**, në të cilën impakti i internetit mbi radikalizimin është përshkruar si më poshtë:

*“Teknologjitë moderne të informacionit dhe komunikimit luajnë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e kërcënimit që është përfaqësuar aktualisht nga terrorizmi: ato mund të shërbejnë si një mjet për përhapjen e propagandës me qëllim të mobilizimit dhe rekrutimit si dhe në udhëzime dhe manuale “online” të destinuara për trajnim ose planifikim të sulmeve. Interneti, në veçanti, mund të shërbejë si një nga nxitësit kryesore të proceseve të radikalizimit dhe rekrutimit: ajo është përdorur për të frymëzuar dhe për të mobilizuar rrjetet lokale dhe individët në Evropë dhe gjithashtu shërben si një burim i informacioni mbi mjetet dhe metodat terroriste, duke funksionuar në këtë mënyrë si një "kamp stërvitor virtual". Përhapja e propagandës terroriste dhe ekspertizës terroriste përmes internetit, ka çuar për rrjedhojë në fuqizimin e terroristëve dhe rritjen e kërcënimit të tyre.”*

Edhe UNESCO (tetor 2015) ka rënë dakord me këto pikëpamje duke shprehur “shqetësimin për rritjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe sfidën globale të rekrutimit dhe radikalizimit në ekstremizëm të dhunshëm të të rinjve në mediat sociale, në komunitete dhe në shkolla”. Në vijim të saj, shtetet anëtare të UNESCO-s miratuan **vendimin nr.197 EX/46**, me synim rritjen e kapaciteteve të kësaj Organizate, për të ofruar asistencën e nevojshme në hartimin e strategjive adekuate për parandalizmin e ekstremizmit të dhunshëm.

UNESCO është gjithashtu e angazhuar për zbatimin e Planit të Veprimit të OKB-s për parandalimin e ekstremizmit, me një fokus të veçantë në prioritetet që lidhen direkt me punën e kësaj organizate: i) edukim, zhvillimin e aftësive dhe lehtësi në punësim; ii) fuqizimi i të rinjve; iii) komunikimet strategjike, internet dhe media sociale dhe iv) barazia gjinore dhe fuqizimi i grave.

*Si konkluzion vërejmë se është e qartë se komuniteti ndërkombëtar ka treguar jo vetëm ndërgjegjësim, por ka ndërmarrë, gjithashtu, hapa thelbësore që përfshijnë zbatimin e ligjit, arsimimin dhe iniciativa politikash, për të adresuar rreziqet e krijuara nga radikalizimi nëpërmjet internetit.*

Duke qenë se ekstremizmi i dhunshëm është një dukuri bashkëkohore globale dhe, aktualisht, përbën një kërcënim serioz ndaj paqes e sigurisë ndërkombëtare, në planin kombëtar, një ndër masat e marra nga qeveria shqiptare, në aspektin ligjor, është miratimi i **Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 930, datë 18.11.2015 “Për miratimin e strategjisë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm dhe planit të veprimit”**. Për të parandaluar me sukses përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm, duhen përpjekje të lokalizuara, përfshi fuqizimin e mëtejshëm të të rinjve, familjes, grave dhe pakicave. Duke i kanalizuar këto përpjekje drejt rrjeteve fetare, kulturore dhe arsimore, Strategjia do të sigurojë përfshirjen e shoqërisë civile, si e tërë, në miratimin e një qasjeje të përshtatur dhe proaktive për trajtimin e kësaj dukurie.

Kjo strategji do t’i japë qeverisë shqiptare mundësinë të hartojë parime drejtuese, politika dhe veprime për t’u përballur me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm. Duke pasur si qëllim të vetin përfundimtar, krijimin e një mjedisi të begatë e gjithëpërfshirës për qytetarët, strategjia në fjalë do të kultivojë, po ashtu, kulturën e respektimit të lirive themelore në mbarë vendin.

Strategjia ka për qëllim parandalimin e ekstremizmit nëpërmjet mbështetjes së edukimit për tolerancë dhe aksesit në zhvillimet profesionale në mbarë vendin, me përfshirjen dhe angazhimin e institucioneve qendrore, lokale, si dhe komuniteteve fetare dhe shoqërisë civile. Për këtë qëllim, ajo parashikon një rol kryesor për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministrinë e Arsimit dhe Ministrinë e Brendshme. Programe të tilla si trajnimi i organeve të zbatimit të ligjit, mbështetja për identifikimin e shenjave të hershme të radikalizimit, si dhe për të promovuar fushatat e koordinuara publike në mediat sociale dhe tradicionale janë gjithashtu pjesë e **Planit të Veprimit** të Strategjisë.

## KAPITULLI II: METODOLOGJIA E APLIKUAR

Kapitulli 2 përshkruan qasjen metodologjike të këtij vlerësimi, duke parashtruar pyetjet kërkimore, qasjen për mbledhjen e të dhënave, aktorët e përfshirë, aktivitetet e zhvilluara, vështirësitë e hasura si dhe analizimin e të dhënave të përfuara.

### 2.1 Qasja metodologjike

Puna kërkimore u përqëndrua në 5 drejtime kryesore:

1. Vlerësimin e nevojave për informacion edukues e sensibilizues tek të rinjtë me qëllim përcaktimin e përmbajtjes së mesazheve dhe diskutimeve ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese;
2. Identifikimin e zërave të besueshëm, si udhëheqës komunitarë, mësues, autoritete fetare, media etj që shërbejnë si model në këto komunitete për të përcjellë mesazhe ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese;
3. Vlerësimin e nivelit të ndikimit të medias sociale në nxitjen e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë;
4. Vlerësimin e faktorëve nxitës të përfshirjes së individëve të caktuar në veprime radikale e të dhunshme;
5. Identifikimin e masave të nevojshme për tu ndërmarrë në kuadër të parandalimit të ndikimit të medias sociale dhe faktorëve të tjerë në nxitjen e ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë e më gjerë;

Puna kërkimore dhe rrjedhimisht vlerësimi fokusohet në tre qytete të vendit, Elbasan, Librazhd dhe Pogradec të cilët, sipas studimeve të fundit konsiderohen qytete që janë përballur me fenomenin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Për të mbledhur të dhënat e nevojshme për vlerësimin e nivelit të ndikimit të medias sociale në nxitjen e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe të faktorëve nxitës të përfshirjes së individëve të caktuar u zhvilluan disa takime me aktorë të ndryshëm (institucione publike, media, komunitete fetare, organizata të shoqërisë civile, mësues, nxënës etj) të cilët:

- kanë njohuri mbi çështjet e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm;
- për hir të kompetencave dhe rolit të tyre duhet të ndërmarrin masa/veprime në drejtim të dobësimit të ndikimit të propagandës ekstremiste duke identifikuar se çfarë është bërë prej tyre deri më sot dhe se çfarë propozohet të realizohet në të ardhmen në këtë drejtim (sipas Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit të saj);
- shërbejnë si model në këto komunitete për të përcjellë mesazhe ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese dhe ndikimi i tyre është thelbësor në luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Për të orientuar diskutimin për secilën kategori të intervistuarish u përgatit paraprakisht një udhëzues diskutimi në të cilin u përcaktuan në mënyrë orientuese dhe jo shteruese të gjithë pyetjet apo temat e diskutimit gjatë takimeve.

Gjithsej u zhvilluan rreth 20 takime me përfaqësues të:

1. Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë si institucioni përgjegjës në zbatimin e disa prej objektivave dhe masave të parashikuar në Strategjinë kombëtare për luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm që shënjestrojnë grupet e marginalizuara, në nevojë, të pa puna apo të cilave iu duhet dhënë ndihmë sociale duke konsideruar gjithashtu, faktin se planet ekzistuese për zgjerimin e shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale do të kenë si përparësi zonat problematike të synuara, të prekura më së shumti nga fenomeni i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
2. Ministrisë së Arsimit dhe Drejtorive Arsimore. Roli i arsimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të de-radikalizimit të rinjve është pranuar në një nivel global. Një hap i rëndësishëm në këtë drejtim ishte lançimi, në dhjetor 2015, i Planit të Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së, e cila njeh rëndësinë e arsimit cilësor për të adresuar këtë fenomen. Në aspektin kombëtar, roli që ka arsimi në përpjekjet për të frenuar dhe parandaluar rritjen e ekstremizmit të dhunshëm, është pranuar edhe nga qeveria shqiptare, në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit në të cilën konfirmohet fakti i konsiderimit të mësuesve si “punonjës të rëndësishëm të vijës së parë”, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve.
3. Bashkisë Elbasan, Librazhd dhe Pogradec. Disa zona gjeografike të vendit janë më të prekshëm ndaj radikalizimit, në mënyrë të veçantë në zonat e vogla me disavantazhe socio-ekonomike, me qasje të pakët në mundësitë e punësimit dhe arsimimit. Gjithashtu, në zonat e marginalizuara, kjo është e shoqëruar shpesh me mungesën e shërbimeve sociale dhe zhgënjimit me institucionet publike. Kjo krijon kushte të favorshme për propagandë ekstremiste, që synojnë kryesisht të rinjtë, të cilët janë grupi kryesor në rrezik. Është e ditur se, në një periudhë afatgjatë, më efektive në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm janë ato politika dhe masat që ndiqen përmes nismave të nxitura lokalisht dhe atyre të bashkëpunimit, që iu përshtaten konteksteve lokale. Në këtë mënyrë, një qasje me në qendër komunitetin do të jetë themelore për ta përqëndruar e nxitur luftën e Shqipërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Masat dhe veprimet e propozuara në strategjinë kombëtare kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm do të zbatohen përmes nismave të nxitura në nivel vendor, bashkëpunimit dhe mbështetjes në partneritet, që përputhen me kontekstin e këtyre masave, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.
4. Policisë së Shtetit përgjegjës për çështjet e terrorizmit. Policia luan një rol tepër të rëndësishëm në luftën kundër terrorizmit, merr rëndësi të posaçme fakti që strukturat e policisë të japin llogari për veprimet e veta, me qëllim garantimin e legjitimitetit, besimit, besueshmërisë dhe mbështetjes nga publiku. Policia ka një rol shumë të rëndësishëm në kuadrin e reagimit të drejtësisë penale ndaj radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, por roli i saj duhet kufizuar tek përpjekjet proaktive parandaluese. Policimi në komunitet, është një nga instrumentat efikase të përpjekjeve parandaluese. Kjo nënkupton vendosjen

e partneritetit midis policisë nga njëra anë dhe publikut të gjerë nga ana tjetër, duke përfshirë policinë, autoritete të tjera publike dhe komunitetet për një zgjidhje proaktive të problemeve, i cili mund të përbëjë një kontribut të prekshëm dhe jetëgjatë në kuadrin e përpjekjeve më të gjera strategjike për parandalimin dhe luftën kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

5. Komunitetit mysliman pasi ekstremizmi i dhunshëm është parë dhe perceptuar shpesh nga mediat dhe publiku i gjerë si i lidhur thellësisht me besimin fetar. Kjo nuk është shume befasuese duke pasur parasysh se shumë nga ekstremistët e dhunshëm përdorin retorikën dhe ideologjinë fetare, si dhe shtrembërojnë interpretimet e shkrimeve fetare për të justifikuar qasjen dhe veprimet e tyre. Duke njohur rolin e udhëheqësve dhe komuniteteve fetare në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe promovimin e dimensionin fetar të dialogut ndërkulturor, Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara ka theksuar në Planin e Veprimit për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm rëndësinë për besimin dhe drejtuesit e komuniteteve fetare e komunitetit për të këshilluar dhe drejtuar "besimtarët vulnerabël me qëllim që ti mundësojnë atyre heqjen dorë nga ideologjitë e dhunshme" dhe për të promovuar "tolerancën, mirëkuptimin dhe pajtimin ndërmjet komuniteteve". Por vetë rolin që drejtuesit e komuniteteve fetare kanë në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është shumë e rëndësishme mbështetja e tyre nga strukturat përkatëse shtetërore si dhe rritja e bashkëveprimit ndërmjet të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Strategjia Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit, ndërmjet të tjerash, njuh dhe stimulon rolin aktiv që duhet të kenë komunitetet fetare, së bashku me aktorë të tjerë, në parandalimin e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
6. Medias në Tiranë, Elbasan, Pogradec, Librazhd. Ka një konsensus pothuajse universal se televizioni, radio dhe media e shkruar janë jashtëzakonisht me ndikim në mënyrën se si njerëzit mendojnë apo perceptojnë ngjarje të caktuara. Gjithashtu, është konstatuar mungesa e monitorimit dhe e kujdesit nga ana e gazetarëve në mënyrën se si ata paraqesin çështjet që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin duke prekur shpesh herë ndjeshmëritë e komuniteteve fetare.
7. Shoqërisë Civile duke marrë në konsideratë rolin shumë të rëndësishëm që ajo ka në përcimin e mesazheve që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, bashkëjetesën etj, nëpërmjet bashkëpunimit me institucione publike dhe median. Shoqëria civile nëpërmjet realizimit të aktiviteteve me karakter kërkimor, monitorues, informues, edukues e advokues si dhe realizimit të aktiviteteve në drejtim të rritjes së kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm (policia, mësues, gazetarë) kontribuon në drejtim të luftës dhe parandalimit të fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
8. Me mësues dhe nxënës gjimnazistë në tre gjimnaze të zonave të Elbasanit, Librazhdit dhe Pogradecit. Roli që ka arsimit në përpjekjet për të frenuar dhe parandaluar rritjen e ekstremizmit të dhunshëm, është pranuar në nivel ndërkombëtar dhe kombëtar. Mësuesit

si “punonjës të rëndësishëm të vijës së parë”, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve kanë detyrën dhe aftësinë për të shquar dhe për t’iu kundërpërgjigjur radikalizimit dhe për ta parandaluar atë përfundimisht.

Në drejtim të ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të të rinjve ndaj fenomenit të radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm dhe përgatitjes së materialeve informuese/edukuese dhe mesazheve sensibilizuese, të dhënat e përftuara u analizuan dhe përfundimet e vlerësimit të zhvilluar dhe parashikimet e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm shërbyen si bazë për:

1. përcaktimin e informacionit dhe mesazheve edukues e sensibilizues për të rinjtë;
2. identifikimin e zërave të besueshëm, si udhëheqës komunitarë, mësues, autoritete fetare, media etj që shërbejnë si model në këto komunitete për të përcjellë mesazhe ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese;

Nga procesi i vlerësimit rezultuan si më të përshtatshme dhe efikase përcjellja e informacioneve dhe mesazheve në drejtim të:

- ✓ përhapjes së vlerave të tolerancës dhe bashkëjetesës fetare përmes proceseve edukuese;
- ✓ nxitja e mendimit kritik tek të rinjtë dhe
- ✓ përcjellja e mesazheve mbështetëse nga institucionet në drejtim të fuqizimit të të rinjve;

Për të përcjellë mesazhet ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese tek të rinjtë, në varësi edhe të përmbajtjes së informacionit/mesazhit që do të përcillej, u identifikuan si zëra të besueshëm:

- përfaqësues të qeverisjes qendrore (DAR);
- përfaqësues të qeverisjes vendore (Bashkisë);
- përfaqësues të komuniteteve fetare;
- mësues, e
- gazetarë.

Fushata e ndërgjegjësimit dhe sensibilizimit të të rinjve u realizua nëpërmjet disa proceseve si:

- ✓ përgatitja e materialeve informuese për të rinjtë e cila përmbante informacion mbi kuptimin e tolerancës, rëndësinë e edukimit, promovimi i qytetarisë dhe vlerave të përbashkëta, lufta ndaj intolerancës, bashkëjetesa fetare etj;
- ✓ përgatitja e një mesazhi të përgjithshëm të Fushatës “Toleranca përmes Edukimit”;
- ✓ zhvillimi i tre ditëve të hapura në tre gjimnaze me më shumë frekuentim në Elbasan, Librazhd dhe Pogradec;
- ✓ përfshirja e aktorëve të ndryshëm përfaqësues të institucioneve publike, mësues, gazetarë përfaqësues të komuniteteve fetare të cilët, nëpërmjet fjalëve të mbajtura përcollën mesazhe të tolerances e bashkëjetesës fetare si dhe informuan të rinjtë mbi masat e marra në nivel vendor për promovimin dhe fuqizimin e të rinjve;

- ✓ përfshirja e të rinjve dhe nxitja e mendimit kritik dhe krijimtarisë së tyre nëpërmjet përgatitjes së pikturave, vizatimeve, reflektimeve, vjershave etj, mbi mënyrën se si ata e konceptojnë dhe kuptojnë tolerancën dhe bashkëjetesën fetare;
- ✓ përfshirja e medias lokale në përhapjen sa më të gjerë të informacionit dhe mesazheve sensibilizuese jo vetëm tek të rinjtë por tek qytetarët e këtyre zonave.

Në përfundim të aktiviteteve të natyrës ndërgjegjësuere dhe sensibilizuese tek të rinjtë, përfundimet e vlerësimit në drejtim të vlerësimit të nivelit të ndikimit të medias sociale dhe të faktorëve të tjerë nxitës të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm tek të rinjtë e më gjerë, u diskutuan me të gjithë aktorët e përfshirë në iniciativë me qëllim identifikimin e masave të nevojshme për tu ndërmarrë në kuadër të luftës kundër fenomenit dhe parandalimit të tij. Rezultatet dhe rekomandimet e nxjerra nga vlerësimi i bërë u konsultuan me përfaqësues të institucioneve publike qendrore dhe vendore, mësues, gazetarë, përfaqësues të komuniteteve fetare dhe organizatave të shoqërisë civile që operojnë në nivel lokal.

## **2.2 Angazhimi i palëve të interesuara dhe vështirësitë e hasura**

Në zbatim të metodologjisë së përcaktuar, palët e interesuara u ftuan të jenë pjesë e projektit nëpërmjet pjesëmarrjes së tyre në procesin e mbledhjes së të dhënave, në fushatën ndërgjegjësuere të të rinjve apo në diskutimin e rekomandimeve.

Gjatë aktivitetit të parë të projektit u përfshin një sërë aktorësh me të cilët u zhvilluan takime për të diskutuar lidhur me nivelin e ndikimit të medias sociale në nxitjen e radikalizmit fetar dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri dhe të faktorëve nxitës të përfshirjes së individëve të caktuar. Angazhimi dhe kontributi i pothuajse të gjithë aktorëve të përfshirë në projekt ka qenë maksimal.

Megjithatë, gjatë fazës së mbledhjes së të dhënave dhe përpunimit/analizimit të tyre u vunë re disa vështirësi/problematika të cilat mund ti përmbledhim si më poshtë:

- ✓ mospërputhje midis të dhënave të përcjella nga institucione të ndryshme;
- ✓ vlerësim nganjëherë i ndryshëm i palëve të interesuara mbi karakteristikat e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri;
- ✓ mungesë e njohurive të thelluara të disa prej institucioneve publike përgjegjëse për zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm lidhur me objektivat dhe masat që parashikon ky dokument për tu realizuar prej tyre.

## **KAPITULLI III VLERËSIMI I NDIKIMIT TË MEDIAS SOCIALE DHE I FAKTORËVE TË TJERË NË NXITJEN E RADIKALIZIMIT DHE EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM TEK TË RINJTË**

Tema e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm është bërë vitet e fundit pjesë e diskutimeve të ndryshme mediatike, por jo vetëm. Rëndësia e kësaj çështjeje ka qenë e drejtuar në një masë të madhe nga shqetësimet e krijuara nga ngjarjet e ndodhura në Irak dhe Siri, pjesëmarrjen e luftëtarëve të huaj në këto konflikte, përfshirë dhe qytetarë shqiptarë. Roli i mediave sociale dhe shtrirje globale duke kapërcyer kufijtë kombëtare ka ilustruar anën negative të rritjes së komunikimit global, lëvizshmërinë dhe lidhjeve, si dhe ka treguar kërcënimet e reja të sigurisë.

Ka një pranim gjithnjë e në rritje se masat tradicionale kundër terrorizmit nuk mund të jenë të mjaftueshme për të adresuar me sukses manifestimet e dhunshme të ekstremizmit dhe terrorit. Masat për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe kundërvënia ndaj këtij fenomeni kërkojnë që të reduktohen realisht faktorët e riskut.

### **3.1 Vlerësim mbi karakteristikat dhe faktorët nxitës së fenomenit të radikalizmit në Shqipëri**

Nga kontaktet dhe takimet e zhvilluara me institucionet përkatëse shtetërore, ky fenomen konsiderohet i veçuar, jo aq shqetësues krahasuar me Kosovën apo Maqedoninë, dhe se arsyet/faktorët që kanë shtyrë të rinjtë shqiptar për të qenë pjesëmarrës në zonat e luftës, janë të ndryshme. Këto arsye fillojnë që nga:

- formësimi i bindjeve radikale si rrjedhojë e kontakteve me prijës radikale jashtë strukturave të Komunitetit Musliman;
- kushtet e vështira social-ekonomike;
- mungesa e arsimimit dhe edukimit të nevojshëm;
- forcimi i bindjeve radikale nëpërmjet propagandës dhe komunikimit në rrjetet sociale,
- njohjeve personale apo fafeshnore ndërmjet të rinjëve të radikalizuar.
- izolimi dhe mungesa e angazhimit në komunitet.

Arsyet e mësipërme janë identifikuar si faktorë që kontribuojnë në radikalizimin e individit (faktorë “nxitës”) dhe shërbejnë për të nxitur apo ndikuar tek një individ që ata të bëhen të pambrojtur ndaj radikalizmit. Ka një tendencë të thuhet se ajo që është më e nevojshme për të parandaluar radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm është zhvillimi ekonomik dhe investimet në infrastrukturë. Megjithatë, kur diskutohet më tej, pranohet se ekziston një faktor ideologjik në një kontekst më të gjerë ndërkombëtar i cili, duhet të merret gjithashtu në konsideratë.

Duhet të theksohet se lëvizjet e të rinjëve shqiptarë drejt zonave të luftës, i përkasin kryesisht vitit 2013-2014 dhe të paktën që nga vititi 2014, nuk është konstatuar pjesëmarrja e ndonjë qytetari shqiptar në zonat e luftës. Rreth 114 shtetas shqiptar të moshës 30-35 vjeçare, disa prej



tyre së bashku me anëtarët e familjes, janë larguar nga vendi për t'u bashkuar me zonat e luftës në Lindjen e Mesme ndërkohë që rreth 40 prej tyre janë kthyer në Shqipëri<sup>1</sup>.

Nga takimet e zhvilluara me aktorë të ndryshëm në zonat e mbulura nga projekti, është konfirmuar se komunikimi me të kthyerit nga frontet e luftës mbetet i vështirë pasi ata jetojnë të veçuar dhe nuk bëjnë jetë komunitare. Edhe vetë strukturat e komunitetit musliman e kanë pasur të vështirë komunikimin me to (për të kuptuar edhe arsyet e vendimit për të qenë pjesë e këtyre konflikteve ushtarake), për shkak të mos njohjes dhe refuzimit që këta individë shprehin edhe ndaj strukturave të komunitetit musliman. Gjithashtu, asnjë politikë nuk është ndjekur dhe asnjë masë nuk është marrë për riintegrimin e tyre social dhe në komunitet.

Së fundi, nga gjykatat shqiptare (Gjykata e Krimeve të Rënda Tiranë, Shkalla e Parë dhe Apeli) është dhënë vendimi i dënimit me burgim për një grup personash të akuzuar dhe dënuar si nxitës të terrorizmit dhe rekrutimit të të rinjve në zonat e konfliktit. Pas këtij vendimi të gjykatave shqiptare një tjetër shqetësim është ngritur nga strukturat ligj-zbatuese që është risku i shfaqes së fenomenit të radikalizimit në burgje. Strukturat përgjegjëse kanë marrë masat e nevojshme për monitorimin e situatës në vendet e vuajtjes së dënimit.

Duhet theksuar se është bërë shumë pak në lidhje me përmirësimin e politikës penale për çështjen e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si në aspektin e analizës ashtu dhe në atë praktik. Ndërkohë që Strategjia Kombëtare e luftës kundër ekstremizmit të dhunshëm, miratuar nga Qeveria shqiptare, përfshin referenca në lidhje me *“Krijimin e nismave të formimit profesional dhe ndihmës për punësim në institucionet riedukuese, për të lehtësuar rehabilitimin dhe riintegrimin e autorëve të veprës së ekstremizmit të dhunshëm*, ekziston një arsye bazike që për shkak të legjislacionit të miratuar, të rinjtë që kanë shkuar në vatrat e konfliktit hezitojnë të kthehen në atdhe për arsye të frikës së ndjekjes penale dhe dënimeve penale të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.

Ndërkohë që edhe vetë problematikat e sistemi gjyqësor shqiptar, me zvarritjen e procedurave gjyqësore apo dhe me vendimet shumë herë të diskutueshme përsa i përket ligjshmërisë së tyre, mund të jetë një shtysë në vetvete drejt radikalizimit të mëtejshëm të të rinjve që janë pjesë e këtyre proceseve si dhe influencës së tyre tek personat e tjerë në vendet e vuajtjes së dënimit.

Gjithashtu, vëmendja e të gjithë aktorëve të përfshirë në luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm duhet të përqëndrohet edhe në zona të tjera të vendit të prekura nga fenomene të tilla (zona në veriun e Shqipërisë si Kukësi apo Dibra) në të cilat fenomeni mund të jetë po aq shqetësues sa në zona tashmë të evidentuar si të tilla dhe që kanë përfituar vëmendjen e shtetit dhe të aktorëve të tjerë.

---

<sup>1</sup> Violent Extremism and Religious radicalization in Albania, a report by the Albanian Institute of International Studies, 2015, page 4.

### 3.2 Vlerësimi i nivelit të ndikimit të medias sociale

Për sa i përket nivelit të ndikimit të medias sociale në nxitjen e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri lind nevoja e dallimit të dy momenteve të ndryshme të fenomenit të radikalizmit. Së pari, ndikimi që mund të ketë përdorimi i medias sociale tek individë të radikalizuar dhe ndikimi që mund të ketë në radikalizimin e përdoruesve të saj dhe kryesisht tek të rinjtë.

Të gjithë aktorët e intervistuar konsiderojnë se përdorimi i medias sociale nga individë në të cilët bindjet radikale janë formësuar nga faktorë të tjerë nxitës i shërben forcimit të bindjeve radikale të tyre dhe krijon lehtësi komunikimi midis strukturave rekrutuese radikale.

Ndërkohë që propaganda radikale dhe ekstremiste që zhvillohet në median sociale konsiderohet si faktor nxitës dhe promovues i radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, veçanërisht tek të rinjtë. Megjithatë, konsiderohet se vetëm propaganda në median sociale nuk është e mjaftueshme dhe nuk përben faktor determinant në radikalizimin e individit. Ndikimi i medias sociale nuk mund të shihet i veçuar nga faktorët e tjerë që veprojnë krah për krah me instrumentet “online” që i forcojnë më tej këto mesazhe radikale të marra. Është e rëndësishme të theksohet se media sociale konsiderohet gjerësisht si një faktor që mund të promovojë radikalizmin dhe që prek kryesisht të rinjtë e marginalizuar, izoluar apo me problematika ekonomiko-sociale.

Monitorimi dhe kontrolli i propagandës ekstremiste në rrjetet sociale konsiderohet i vështirë ndaj edhe në shumicën e vendeve janë ndërmarrë Fushata të përshtatura në median sociale që përhapin mesazhe kundër radikalizmit dhe ekstremizmit. Iniciativa të ngjashme janë parashikuar edhe në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe në Planin e Veprimit për të luftuar kundër përhapjes së mesazheve e të gjuhës ekstremiste. Megjithatë, deri më sot vërehet një mungesë totale e fushatave sensibilizuese dhe ndërgjegjësuere në rrjetet sociale.


### 3.3 Idenfikimi i problematikave në parandalimin e fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm

#### *Papunësia dhe mungesa e angazhimit në komunitet*

Shumica e të rinjve e gjejnë veten në një shoqëri dhe ambient ku është e vështirë për të gjetur një punë, ose të lëvizin lirshëm në Evropë për të kërkuar kushte më të mira. Në krye të kësaj pasigurie themelore, mund të shtohen edhe faktorë të tjerë, siç janë mundësitë për t'u angazhuar me komunitetet e tyre dhe me njëri-tjetrin, për të gjetur forume të hapura për diskutim dhe edukim në shkolla.

Për aq kohë sa të rinjtë e papunë, në zonat me mundësi të kufizuara punësimi, janë shënjestra të lehta dhe mund të bien preh e radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, është e rëndësishme

ndërmarrja e veprimeve që nxisin politika e programe aktive të përmirësuara e të diversifikuara, të tregut të punës, akses më të madh në shërbimet sociale, mbështetjen e nismave publike dhe private në këtë drejtim, duke pasur përparësi zonat e prekura më së shumti, nga fenomeni i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, por jo vetëm.

 *Forcimi i veprimeve në drejtim të sigurimit të policimit në komunitet në zonat problematike*

Një element shumë i rëndësishëm është dhe roli i strukturave ligj-zbatuese, në mënyrë të veçantë i strukturave të policisë. Lufta ndaj këtij fenomeni kërkon një qasje gjithëpërfshirëse, duke i kushtuar vëmendje të veçantë përpjekjeve proaktive parandaluese si dhe respektimit në të njëjtën kohë të të drejtave të njeriut dhe shtetit ligjor.

Efikasiteti dhe legjitimiteti i veprimeve të strukturave ligj-zbatuese do të minoheshin, nëse këto struktura do të përdornin pushtetin e tyre për të shkelur standardet ndërkombëtare të të drejtave të njeriut. Duke qenë se në këtë kontekst, policia luan një rol tepër të rëndësishëm në luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm, merr rëndësi të posaçme fakti që strukturat e policisë, të japin llogari për veprimet e veta, me qëllim garantimin e legjitimitetit, besimit, besueshmërisë dhe mbështetjes nga publiku. Kjo pasi sjellja korrekte e organeve të rendit ndaj individëve të radikalizuar, familjarëve të tyre apo dhe ndaj individëve në risk, do të ndihmonte në rehabilitimin dhe kthimin e individëve të tillë në shoqëri/komunitet pa pasoja, ndërsa keqsjellja, vetëm sa prodhon edhe më tepër ekstremizëm dhe radikalizëm.

Policimi në komunitet, duhet të jetë një nga instrumentat efikase të përpjekjeve parandaluese. Kjo nënkupton vendosjen e partneritetit midis policisë nga njëra anë dhe publikut të gjerë nga ana tjetër, duke përfshirë policinë, autoritete të tjera publike dhe komunitetet, për një zgjidhje proaktive të problemeve, i cili mund të përbëjë një kontribut të prekshëm dhe jetëgjatë në kuadrin e përpjekjeve më të gjera strategjike, për parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Gjithsesi, Policimi në komunitet nuk mund të funksionojë si një instrument më vete në përpjekjet për parandalimin dhe luftën kundër radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Ai duhet të jetë pjesë përbërëse e një strategjie gjithëpërfshirëse, koherente, në përputhje me të drejtat e njeriut. Në luftimin e këtyre dukurive, bashkëpunimi me komunitetin e besimtarëve është i domosdoshëm dhe garanton më shumë efektivitet.

### *Mungesa e veprimeve të vazhdueshme komunitare e edukuese nga ana e institucioneve arsimore*

Rëndësia e arsimit si një mjet për të ndihmuar në parandalimin e terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, si dhe intolerancën racore dhe fetare, gjenocidin, krimet e luftës dhe krimet kundër njerëzimit në mbarë botën, është tashme i pranuar ndërkombëtarisht. Pavarësisht nëse kjo ofrohet nëpërmjet shkollave, klubeve dhe shoqatave të komunitetit apo në shtëpi, arsimit është me të vërtetë, i njohur si një komponent i rëndësishëm i një angazhimi shoqëror për të frenuar dhe parandaluar rritjen e ekstremizmit të dhunshëm.

Askush nuk lind ekstremist i dhunshëm, ato instrumentalizohen dhe ushqehen me këtë frymë. Lufta ndaj procesit të radikalizimit duhet të fillojë me njohjen e të drejtave të njeriut dhe shtetin e së drejtës, duke fuqizuar të rinjtë dhe të rejtat dhe duke e filluar këtë proces që nga bankat e shkollës.

Ky rol është pranuar edhe nga qeveria shqiptare, në Strategjinë Kombëtare për Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Planit të Veprimit (Nëntor 2015), ku mësuesit konsiderohen “punonjës të rëndësishëm të vijës së parë”, të cilët shërbejnë si ndërlidhës brenda komuniteteve dhe që për rrjedhojë, aftësia e tyre për të shquar, kundërpërgjigjur dhe parandaluar radikalizimin, duhet forcuar.

### *Mungesa e trajnimit të mësuesve dhe e kurrikulave të posaçme*

Pavarësisht këtij dokumenti strategjik, konstatohet se niveli i zbatueshmërisë mbetet i ulët në drejtim të trajnimit të mësuesve, duke pasur parasysh rolin e tyre ndaj këtij fenomeni, si dhe në aspektin e rritjes së ndërgjegjësimit publik tek të rinjtë e shkollave, nëpërmjet përcjelljes së mesazheve të paqes, tolerancës përmes edukimit, bashkëjetesës fetare etj.

Për rrjedhojë është i domosdoshëm jo vetëm zbatimi i kësaj strategjie në të gjithë komponentët e saj, por edhe vlerësimi i nevojës për zhvillimin e kurrikulave të nevojshme në sistemin arsimor para-universitar që lidhen në mënyrë të veçantë me promovimin të dialogut ndërkulturor, tolerances, bashkëjetesës fetare, respektit reciprok, etj.

### *Media dhe roli i saj në përcjelljen e mesazheve të tolerancës, paqes dhe bashkëjetesës fetare*

Media dhe fuqia e saj konsiderohet një nga faktorët e tjerë potencial, që duhet të merret në konsideratë kur flasim për fenomenin radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Prandaj, është shumë e rëndësishme që media të transmetojnë një informacion të besueshëm dhe të balancuar, si dhe identifikimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të forta dhe të përhershme konsultative me zëra të besueshëm, të udhëheqësve fetarë, shoqërisë civile, përmes transmetimit tek publikut të rasteve dhe mesazheve që pasqyrojnë tolerancën, mirëkuptimin, respektin për mendimet dhe besimet e të tjerëve.

Gjithashtu, vlerësohet që media duhet të jetë më e informuar dhe më e kujdesshme në diskursin dhe qasjen e komunikimit me publikun e gjerë për çështje që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm, me qëllim që të shmangen opinione apo komente të cilat mund të çënojnë dhe prekin ndjeshmëritë e komunitetit të besimtarëve.

Në këtë drejtim, shumë e rëndësishme dhe e nevojshme mbetet trajnimi i gazetarëve përsa i përket raportimit mbi këto çështje si dhe i rolit të tyre në lidhje me mbështetjen e debateve mediatike të bazuara në fakte, nëpërmjet rritjes së komunikimit dhe mirëbesimit me përfaqësuesit e komuniteteve fetare.

#### *Mungesa e fushatave ndërgjegjësuese të vazhdueshme dhe gjithëpërfshirëse;*

Konstatohet se të pakta janë nismat që përfshijnë aktorë të ndryshëm si institucionet publike, media, shoqëria civile, komunitetet fetare etj në hartimin dhe përçimin e mesazheve të fuqishme dhe historive alternative, që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, të cilat janë në gjendje të depërtojnë tek audiencat e synuara. Gjithashtu, të pakta janë nismat që synojnë që nëpërmjet zërave të besueshëm në komunitet të përcjellin mesazhe që përkrahin tolerancën, paqen, bashkëjetesën, vlerat demokratike etj duke përdorur kanale dhe mënyra të ndryshme komunikimi (internetin, median, përfshirë dhe median sociale, aktivitete në shkolla apo komunitare etj). Një tjetër problematikë është edhe shtirja e këtyre fushatave ndërgjegjësuese vetëm në disa zona të vendit duke përjashtuar zona të tjera po aq problematike.

#### *Mungesa e nismave lokale në përputhje me karakteristikat dhe veçoritë e zonës*

Është e ditur dhe gjerësisht e pranuar se, në një periudhë afatgjatë, më efektive në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm janë ato politika dhe masat që ndiqen përmes nismave të nxitura lokalisht dhe atyre të bashkëpunimit, që iu përshtaten konteksteve lokale. Në këtë mënyrë, një qasje me në qendër komunitetin duhet të jetë themelore për ta përqendruar e nxitur luftën e Shqipërisë kundër ekstremizmit të dhunshëm. Kjo qasje ka nevojë të mbështetet përmes një bashkërendimi midis institucioneve qeveritare dhe aktorëve të komunitetit lokal.

Masat dhe veprimet kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm do të zbatohen përmes nismave të nxitura në nivel vendor, bashkëpunimit dhe mbështetjes në partneritet, që përputhen me kontekstin e këtyre masave, në funksion të rritjes së efektivitetit dhe qëndrueshmërisë së tyre.

#### *Niveli i ulët i zbatueshmërisë së Strategjisë*

E rëndësishme është edhe vlerësimi i zbatueshmërisë së Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm. Vlen të theksohet se kjo Strategji kërkon të shkojë përtej agjencive të zbatimit të ligjit, në përpjekjen që të përfshijë të gjitha kapacitetet kombëtare (shkollat, mësuesit, punonjësit socialë, bashkësitë fetare), duke synuar mobilizimin e këtyre aktorëve për të bashkëpunuar së bashku për parandalimin e këtij fenomeni.

Për qeverinë shqiptare proçesi i adresimit të këtij fenomeni është një sfidë e re, pasi nuk ka pasur ndonjë eksperiencë të mëparshme në lidhje me përgjigjet ndaj sfidave të këtij lloji. Qeveria shqiptare e konsideron këtë dokument si një hap të parë të rëndësishëm, por pranon që më tepër çështje mund dhe do të duheshin të përfshiheshin, për shembull çështja e sistemit të drejtësisë. Megjithatë strategjia shikohet si një fillim, por që nuk duhet të mbetet vetëm në këtë fazë.

Konstatohet që niveli i zbatimit të kësaj strategjie vazhdon të jetë i ulët, ndërkohë që edhe mekanizmat monitorues janë jo funksional. Të gjithë aktorët qeveritarë ose jo të tillë ndajnë të njëjtin mendim se pa burimet e nevojshme financiare, koordinimin dhe bashkëveprimin e të gjithë aktorëve të përfshirë (organet ligjzbatuese, institucionet shtetërore qendrore dhe lokale, shoqëria civile, komunitetet fetare, shkollat, media etj), si dhe realizimin e aktiviteteve dhe veprimeve konkrete sipas një plani veprimi të mirë-përcaktuar, ky dokument rrezikon të mbesë në letër.

Duke qenë se përpjekjet e institucioneve shtetërore që të adresojnë të gjitha këto sfida mbeten të paadresuara në mënyrën e duhur, ka hapësira dhe ambjent për zhvillim të faktorëve që çojnë në radikalizëm apo ekstremizëm të dhunshëm.

## KAPITULLI IV: REKOMANDIME

Nga analiza tërësore e zhvillimit të fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në Shqipëri, vlerësimit të faktorëve nxitës, kontakteve dhe diskutimeve me të gjithë aktorët e përfshirë, do të sugjerohej vlerësimi dhe zbatimi i rekomandimeve të mëposhtme:

### Për institucionet publike në përgjithësi:

- ✓ Mbështetja dhe shfrytëzimi i studimeve lokale apo kombëtare mbi kushtet, faktorët dhe nxitësit e radikalizmit në dhunë, si dhe nivelet e qëndresës së komunitetit kundrejt fenomenit të radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.
- ✓ Adresimi i faktorëve negativë socialë dhe ekonomikë, si p.sh., korrupsioni dhe mungesa e mirëqeverisjes, pabarazia dhe diskriminimi, mungesa e kohezionit social, si edhe nivelet e larta të papunësisë, në veçanti mes të rinjve.
- ✓ Fuqizimi i institucioneve demokratike dhe shtetit ligjor, duke përfshirë policimin demokratik, nxitjen e dialogut midis shtetit dhe shoqërisë dhe garantimin e respektit për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut.
- ✓ Rritja e luftës kundër intolerancës dhe diskriminimit, nxitja e respektit të përbashkët, bashkekzistencës, marrëdhënieve harmonike mes grupeve etnike, fetare, gjuhësore etj, në mënyrë të veçantë në rritjen e ndërgjegjësimit publik tek të rinjtë, nëpërmjet përcjelljes së mesazheve të paqes, tolerancës përmes edukimit, bashkejtesës fetare etj.
- ✓ Krijimi dhe zbatimi i të gjitha instrumenteve të nevojshëm, në aspektin e kapaciteteve njerëzore dhe financiare, për të mundësuar zbatimin e Strategjisë Kombëtare kundër Ekstremizmit të Dhunshëm si dhe Planit të Veprimit të qeverisë shqiptare.
- ✓ Hartimi dhe zbatimi i politikave sociale në zonat që ndeshen me probleme ekonomike, ku të përfshihen formimi profesional dhe nxitja e punësimit nëpërmjet programeve aktive të përmirësuar e të diversifikuara të tregut të punës, aksesit në shërbime etj, sidomos i grupeve të disavantazhuar, me qëllim sigurimin e barazisë në dinjitetin dhe të drejtat e tyre.
- ✓ Nevoja e zgjerimit të shërbimeve të punësimit dhe formimit profesional në zonat rurale të prekura më së shumti nga fenomeni i radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm si dhe në zonat të cilat kanë probleme të theksuara sociale dhe ekonomike.
- ✓ Marrja e masave të nevojshme për riintegrimin social të të kthyerve dhe familjeve të tyre.

### Për Median

- ✓ Forcimi i rolit të medias dhe nevoja e krijimit të hapësirave të nevojshme për trajtimin e këtij fenomeni nga media elektronike dhe ajo e shkruar, përmes përcjelljes së informacioneve dhe mesazheve të përgjegjshme dhe të balancuarar si dhe identifikimin dhe zhvillimin e marrëdhënieve të forta dhe të përhershme konsultative me zëra të besueshëm të udhëheqësve fetare, shoqërisë civile, përmes transmetimit të publikut të rastve dhe mesazheve që pasqyrojnë tolerancën, mirëkuptimin, respektin për mendimet dhe besimet e tjera.
- ✓ Rritja e rolit konstruktiv të medias në lehtësimin e dialogut dhe diskutimit të lirë dhe të hapur, duke theksuar rreziqet e indiferencës ndaj rritjes së grupeve dhe ideologjive intolerante, si dhe duke mos cënuar apo prekur sensibilitetet e komuniteteve fetare.
- ✓ Trajnimi i gazetarëve përsa i përket raportimit mbi këto çështje si dhe i rolit të tyre në lidhje me mbështetjen e debateve mediatike të bazuara në fakte, nëpërmjet rritjes së komunikimit dhe mirëbesimit me përfaqësuesit e komuniteteve fetare.
- ✓ Përfshirja e medias në hartimin e përcimin të mesazheve të fuqishme dhe historive alternative, që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, të cilat janë në gjendje të depërtojnë tek audiencat e synuara duke përdorur kanale dhe mënyra të ndryshme komunikimi.

### Për Institucionet arsimore

- ✓ Nevoja e trajnimit të mësuesve (si punonjës të vijës së parë), duke ditur që roli i arsimit në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe të de-radikalizimit të të rinjve është pranuar në një nivel global, duke e parë shkollën si qendër komunitare.
- ✓ Nevoja e zhvillimit të kurrikulave të nevojshme në sistemin arsimor parauniversitar që lidhen në mënyrë të veçantë me promovimin të dialogut ndërkulturor, tolerancës, bashkëjetesës fetare, respektit reciprok, përmes të gjitha formave të mësimnxënies;
- ✓ Nevoja e rritjes së mendimit kritik, sidomos nga të rinjtë, në kuptimin, vlerësimin dhe analizimit e mesazheve mediatike (MediaLiteracy), në mënyrë të veçantë në përdorimin e internetit dhe medias sociale, me qëllim për të zhvilluar rezistencën ndaj diskriminimit dhe indoktrinimit.
- ✓ Përhapja e vlerave të tolerancës dhe bashkëjetesës përmes arsimimit duke e parë shkollën si qendër komunitare;



#### Për Policinë e Shtetit

- ✓ Nevoja e zhvillimit dhe forcimit të policimit në komunitet, si një nga instrumentat efikase të përpjekjeve parandaluese, duke rritur në këtë mënyrë nivelin e besimit dhe bashkëpunimit që ekziston midis forcave të policisë dhe publikut të gjerë.
- ✓ Nevoja e trajtimit nga strukturat e policisë të çështjeve që lidhen me radikalizmin dhe ekstremizmin e dhunshëm me vërtetësi, pa paragjykime të tepruara sigurie, në përputhje të plotë me standartet kombëtare dhe ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, duke u kufizuar më shumë tek përpjekjet proaktive parandaluese.
- ✓ Monitorimi dhe vlerësimi i situatës në burgje, përfshirë kushtet që mund të çojnë në radikalizëm, sidomos përsa i përket individëve që konsiderohen në “risk”, si një hap i parë në drejtim të zhvillimit të opsioneve të rehabilitimit.

#### Për Qeverisjen Vendore (Bashkitë)

- ✓ Të thellojnë analizat e tyre mbi natyrën e saktë të ekstremizmit të dhunshëm në nivel lokal dhe kombëtar, përmes nxitjes së analizave lokale, kërkimeve dhe ndarjes së informacionit mbi shkaqet që çojnë drejt radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm në të gjitha format e tij dhe për të gjithë segmentet e shoqërisë, përfshirë gratë dhe fëmijët, si dhe rrugët dhe mënyrat më të mira për ta luftuar atë.
- ✓ Nevoja e rritjes së efektivitetit të luftës kundër radikalizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm përmes politikave dhe masave që ndiqen përmes nismave të nxitura lokalisht dhe atyre të bashkëpunimit, që iu përshtaten konteksteve lokale. Në këtë mënyrë, një qasje lokale me në qendër komunitetin do të jetë themelore për të nxitur masat ndaj këtij fenomeni, përmes një bashkërendimi midis institucioneve qeveritare dhe aktorëve të komunitetit lokal (pushteti vendor, shoqëria civile, shkolla, komunitetet fetare, media).

#### Për Komunitetet Fetare

- ✓ Përfshirja e mëtejshme e komuniteteve fetare në përcimin e mesazheve që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, bashkëjetesën;
- ✓ Identifikimin e zërave të besueshëm të udhëheqësve fetare për të përdorur internetin dhe median, përfshirë dhe median sociale, në ofrimin e këtyre mesazheve.
- ✓ Mbështetja e vazhdueshme, nga ana e komuniteteve fetare për të këshilluar dhe drejtuar besimtarët vulnerable me qëllim që ti mundësojnë atyre heqjen dorë nga ideologjitë e dhunshme dhe për të promovuar tolerancën, mirëkuptimin midis komuniteteve.

- ✓ Rritja e bashkëpunimit dhe mbështetjes së iniciativave të aktorëve të ndryshëm që veprojnë në drejtim të parandalimit të fenomenit.

 Për Organizatat e Shoqërisë Civile

- ✓ Përfshirja e mëtejshme e shoqërisë civile në përçimin e mesazheve që përkrahin tolerancën, paqen, të drejtat e njeriut e vlerat demokratike, bashkëjetesën etj nëpërmjet bashkëpunimit me institucione publike dhe median;
- ✓ Realizimi i aktiviteteve me karakter kërkimor, monitorues, informues, edukues e advokues në drejtim të luftës dhe parandalimit të radikalizmit;
- ✓ Realizimi i aktiviteteve në drejtim të rritjes së kapaciteteve të aktorëve të ndryshëm (policia, mësues, gazetarë) në drejtim të luftës dhe parandalimit të fenomenit;
- ✓ Të nxisë bashkëpunimin midis institucioneve publike dhe komunitetit në drejtim të aktiviteteve të përbashkëta me bazë komunitetin;
- ✓ Të vlerësojë dhe përcjellë në mënyrë të vazhdueshmë shqetësimet sociale dhe ekonomike të komunitetit/grupeve vulnerabël.